

258
16.10.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

Nr. 1201/1 Prot.

Tiranë më 15.10. 2020

LËNDA: Dërgohen Vendime të Rektoratit
DREJTUAR: Fakultetit Teknologji e Informatikës
Drejtoria e Kurrikulave
Drejtoria e Kërkimit Shkencor
Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

Bashkëngjitur po ju përcjellim dy vendime te Rektoratit:

1. Vendimin Nr. 142, datë 15.10.2020 "Për ndryshimin e strukturës mësimore të vitit akademik 2019-2020, i ndryshuar".

2. Vendimin Nr. 141, datë 15.10.2020 "Për caktimin e afatit maksimal te dorëzimit të certifikatës së njohjes së gjuhës së huaj, për studentët/aplikantët e regjistruar në programet e studimit "Master i Shkencave" të UPT, për vitin akademik 2019-2020 dhe 2020-2021"


Fakultetet të marrin masat për zbatimin e tyre dhe për njoftimin e njësive përkatëse dhe të studentëve.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

Rektori
Prof. Dr. Andrea MALIQARI

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANES

Adresa: Sheshi "Nene Tereza", Nr.4, Tirane,
Tel/Fax: +355 4 2227914,
web: www.upt.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI

Nr. 1201 Prot.

Tiranë më 15.10. 2020

VENDIM Nr. 142 dt. 15.10.2020

Për

"Ndryshimin e Strukturës mësimore të vitit akademik 2019-2020, i ndryshuar"

Rektorati i Universitetit Politeknik të Tiranës, në zbatim të Ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nisur nga kushtet e krijuara nga pandemia COVID-19 dhe ndryshimet e bëra në strukturën mësimore, mbështetur në propozimet e drejtuesve të njësjive kryesore, vendosi:


1. Sesioni i vjeshtës për mbrojtjen e diplomave, në gjithë UPT, për vitin akademik 2019-2020, të zgjatet deri në datën 06 Nëntor 2020.

Ngarkohen Fakultetet për zbatimin e këtij Vendimi.

Rektori

Prof. Dr. Andrea MALIQARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI

Nr. 1200 Prot.

Tiranë, 15 . 10 . 2020

V E N D I M

Nr. 141, datë 15 . 10.2020


Për

“Caktimin e afatit maksimal të dorëzimit të certifikatës së njohjes së gjuhës së huaj, për studentët/aplikantët e regjistruar në programet e studimit “Master i Shkencave” në UPT, për vitin akademik 2019-2020 dhe 2020-2021”

Në zbatim të kërkesave të Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nisur nga kushtet e krijuara si rezultat i pandemisë COVID-19 dhe rregullave të marra për përballimin e saj, Rektorati i Universitetit Politeknik të Tiranës vendosi:

1. Afati maksimal i dorëzimit të certifikatave të njohjes së gjuhës së huaj për studentët e ciklit të dytë Master i Shkencave të regjistruar për herë të [parë në vitet akademike 2019-2020 dhe 2020-2021 do të jetë para fillimit të sesionit të mbrojtjes së diplomave.
2. Certifikatat e njohjes së gjuhës së huaj duhet të jenë në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Nr.52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të Gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar dhe Udhëzimit Nr.11, datë 10.04.2017, “Për një ndryshim të Udhëzimit Nr.52 datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të Gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar”.
3. Në rast të mosrespektimit të këtij afati, studenti nuk do të lejohet të hyjë në mbrojtje të diplomës.

Ngarkohen Fakultetet për zbatimin e këtij Vendimi dhe shpalljen e tij në mjediset publike të fakultetit.



Rektori
Prof. Dr. Andrea MALIQARI

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANES

Adresa: Sheshi “Nene Tereza”, Nr.4, Tirane,
Tel/Fax: +355 4 2227914,
web: www.upt.al